



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.69

21 maj

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.486, datë 8.4.2008	Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit 3023
Vendim i KM nr.487, datë 16.4.2008	Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. 3023
Vendim i KM nr.501, datë 1.5.2008	Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2008, miratuar për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, për zhvillimin e projektit “Via Albania”..... 3025
Vendim i KM nr.502, datë 16.4.2008	Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar..... 3025
Vendim i KM nr.503, datë 16.4.2008	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë..... 3029
Vendim i KM nr.505, datë 1.5.2008	Për përdorimin e të ardhurave nga privatizimi i paketës së aksioneve shtetërore të mbetura të AMC sh.a.-së, dhe për një ndryshim në vendimin nr.410, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e paketës së aksioneve të AMC sh.a.-së, që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, tek ish-pronarët e truallit dhe te punonjësit e kësaj shoqërie”..... 3030
Vendim i KM nr.506, datë 1.5.2008	Për një shtesë në vendimin nr.315, datë 21.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në bashkinë Vorë, në komunat Kashar e Prezë të qarkut të Tiranës, dhe në komunat Maminas, Manzë dhe Bubq të qarkut të Durrësit, të shkaktuara nga aksidenti teknologjik” 3031

Udhëzim i MPPTT nr.4, datë 25.4.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.12, datë 19.7.2007 “Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e bllokut të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi”.....	3032
Vendim i BSH nr.31, datë 30.4.2008	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”.....	3037
Vendim i KNSH nr.24, datë 2.5.2008	Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit	3045
Vendim i KNSH nr.25, datë 2.5.2008	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW	3047
Vendim i ERE nr.50, datë 18.4.2008	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2008 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike	3049
Vendim i ERE nr.51, datë 9.5.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k.....	3050
Vendim i ERE nr.52, datë 9.5.2008	Për një shtesë në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike”	3051
Kërkesë e MPPTT nr.2666/1, datë 30.4.2008	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrëshen – Kalimash”.....	3051

VENDIM
Nr.486, datë 8.4.2008

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR TRANSPORTIMIN E MËSUESVE
DHE TË NXËNËSVE QË PUNOJNË E MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet e transportimit të mësuesve që punojnë larg vendbanimit, në distancë mbi 4 km, dhe kthehen brenda ditës, si dhe shpenzimet e transportimit të nxënësve që ndjekin arsimin e detyrueshëm larg vendbanimit, në distancë mbi 2 km, të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit.
 2. Shërbimi i transportimit të mësuesve dhe nxënësve kryhet vetëm në rastet e linjave interurbane. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore përcaktojnë hartën e linjave për distancat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe listën e mësuesve dhe të nxënësve, që do të lëvizin në këto linja, të miratuar nga drejtorët e shkollave.
 3. Shpenzimet dhe fondi limit për këto shërbime prokurohen në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nga çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore, sipas hartës së miratuar të linjave.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
 5. Vendimi nr.208, datë 8.5.1997 i Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit e nxënësit, që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.
 6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.487, datë 16.4.2008

**PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË, TË
INTERESUAR PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT
TË SHPËRNDARJES” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9889, datë 20.3.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forma e tenderit për përzgjedhjen e investorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., të jetë tender i hapur ndërkombëtar, me një fazë, me parakualifikim.
2. Ndërmjet investorëve që kanë dërguar shprehjen e interesit për parakualifikim, sipas kërkesave të përcaktuara në njoftimin publik, të publikuar në përputhje me vendimin nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë

dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, ftesa për pjesëmarrje në tender do t’u dërgohet vetëm kandidatëve, që përmbushin kriteret e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi, sipas afateve të parashikuara në dokumentet e tenderit.

3. Investitorët strategjikë të interesuar, që mund të jenë shoqëri apo bashkim i përkohshëm shoqërisht për t’u parakualifikuar dhe për t’u ftuar për paraqitjen e ofertës së tyre të detyrueshme, duhet të përmbushin, paraprakisht, kriteret e mëposhtme teknike dhe financiare:

Kriteret teknike

- Sasia e energjisë së furnizuar përdoruesve fundorë - sasia e energjisë elektrike e shitur (GWh), matur në bazë të të dhënave operacionale të vitit 2007, duhet të jetë jo më pak se 10 000 GWh.

- Numri i përdoruesve, që u ofrohet shërbimi nga një operator shpërndarjeje, duhet të jetë jo më pak se 500 000.

- Të kenë eksperiencë, jo më pak se 3 vjet në menaxhimin dhe operimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga 110 kV deri 0.4 kV, dhe jo më pak se 20 000 km rrjet shpërndarjeje.

- Të kenë eksperiencë jo më pak se 2 vjet, në rastin e një bashkimi të përkohshëm shoqërisht, ndërsa anëtari udhëheqës duhet të ketë të paktën jo më pak se 2 vjet përvojë në një treg energjie elektrike të liberalizuar (strukturuar mbi kontrata dypalëshe), kur jo më pak se 30 për qind e këtij tregu është deklaruar ligjërisht, e hapur për konkurrencë nga qeveria ose autoritetet rregullatore të vendit të operimit.

Kriteret financiare

- Kandidatët e mundshëm apo, në rastin kur kandidati është bashkim i përkohshëm shoqërisht, të paktën anëtari udhëheqës duhet të ketë pasur një vlerë neto (vlera totale e aseteve (aktive), minus vlerën totale të detyrimeve (pasive)) jo më pak se 1 miliard euro ose ekuivalentin e saj në fund të çdo viti, për 3 (tri) vitet e fundit financiare.

- Kandidati i mundshëm ose, në rastin e një bashkimi të përkohshëm shoqërisht, të paktën anëtari udhëheqës duhet të zotërojë një shkallë besueshmërie për kreditim, në valutë të huaj ose në monedhën e vendit të operimit (nëse kjo është lehtësisht e konvertueshme), të paktën “BB minus” nga Standard & Poor’s ose “BBA” nga Moody’s Investor Service, ose “BB minus” nga Fitch Ratings, ose “BB minus” nga Thomson Bank Watch.

Ofertuesi i mundshëm duhet të deklarojë dhe garantojë, gjithashtu, se nuk i është nënshtruar procedurave të falimentimit ose likuidimit, se është i regjistruar, si subjekt ligjor, në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës, se nuk është dënuar apo akuzuar për mashtrim, korrupsion, pastrim parash ose pjesëmarrje në vepra penale dhe se nuk ka dijeni për ndonjë konflikt interesi apo konflikt të mundshëm interesi, që vjen si pasojë e kontratave apo marrëdhënieve të mëparshme ose ekzistuese, të cilat mund të ndikojnë materialisht në aftësitë e tij për pjesëmarrje në projekt.

Të gjitha këto kërkesa vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse, ose me anë të dokumenteve të tjera, të shkruara, zyrtare.

4. Dokumentet e tenderit për parakualifikimin dhe vlerësimi i ofertave paraprake për parakualifikimin bëhen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i cili krijohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

5. Kandidatët e parakualifikuar njoftohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës apo personi i autorizuar prej tij. Kandidatët, ofertat e të cilëve nuk janë në përputhje me kërkesat e parakualifikimit dhe janë përjashtuar nga faza tjetër e tenderit, kanë të drejtë të paraqesin, brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit të skualifikimit, ankimin me shkrim te Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i cili ua kthen përgjigjen brenda 10 ditëve.

6. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me urdhër të motivuar dhe të bazuar në legjislacionin në fuqi, ruan në çdo çast të drejtën:

- a) të tërhiqet nga procesi i shitjes apo ta ndërpresë atë;

- b) të përjashtojë ndonjë palë të interesuar nga procesi i shitjes, ku kjo e fundit nuk gëzon të drejtën për t’u kompensuar apo dëmshpërblyer nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për rastin kur në çastin e vlerësimit të ofertave ka pushuar së ekzistuari njëri nga kriteret e përzgjedhjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.501, datë 1.5.2008

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR QENDRËN
KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË, PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT
“VIA ALBANIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh për zhvillimin e projektit kinematografik “Via Albania”.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.502, datë 16.4.2008

PËR ADMINISTRIMIN E KONVIKTEVE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të neneve 15 e 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave, materiale e monetare”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e të gjitha funksioneve të administrimit të konvikteve në sistemin arsimor parauniversitar, për arsimin bazë, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional, kombëtar dhe vendor, sipas vendndodhjes territoriale të tyre, si funksion i deleguar njësive të qeverisjes vendore, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kalimin, me transferim kapital, falas, të pasurive shtetërore të luajtshme, ku përfshihen pajisjet e kuzhinave e të mensave, inventarët në përdorim, mallrat ushqimore dhe joushqimore, gjendje në magazinë, në shërbim të konvikteve dhe të mensave, në sistemin arsimor parauniversitar, në adresë të njësive të qeverisjes vendore.
3. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim bëhen nga komisione të përbashkëta, të ngritura nga drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore dhe bashkitë e komunat.

4. Transferimi i ndërtesave të konvikteve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore do të bëhet në zbatim të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, në një fazë të mëvonshme.

5. Njësive të qeverisjes vendore, për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar, t’u shtohen 487 punonjës, të cilët pakësohen nga numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për konviktet dhe të papërdorura deri më 1 korrik 2008, të kalojnë si pjesë e grantit të pakushtëzuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore.

7. Strukturat analitike, numri i punonjësve, rregullat për marrjen në punë, si emërimi, lirimi apo shkarkimi janë kompetencë të organeve të qeverisjes vendore, në zbatim të Kodit të Punës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**NUMRI I PUNONJËSVE SIPAS DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE DHE ZYRAVE ARSIMORE NË KONVIKTET E
SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

DAR/ZA	Punonjësit sipas emërtesës														Gjithsej punonjës
	Nr. i konvik magazinier			Kuzhinier	Nd/kuzhinier	Pjata larëse	Rrobaqepëse	Rroba larëse	Mirëmbajtës	Pastruese	Rojë	Ekonomist	Infermiere	Kaldajist	
DAR Berat	Bashkia Berat	2	2	2	2	7	1	2	2	7	3			0	28
ZA Skrapar	Bashkia Çorovodë	1	1	1	1	3	1	2		2	2				13
DAR Dibër	Bashkia Peshkopi	1	1	4		4	1	3	1	4	3	1	1	0	23
ZA Mat	Bashkia Burrel	1	1	2		2		1		3	2				11
DAR Durrës	Bashkia Durrës	2	2	2	2	2	1	1	1	6	4			1	22
DAR Gjirokastër	Bashkia Gjirokastër	2	3	4		4			1	6	3				21
ZA Tepelenë	Bashkia Tepelenë	1	1	1			1		1	1	1				6
ZA Përmet	Bashkia Përmet	1	1	1			1			1	1				5
DAR Fier	Bashkia Fier	1	1	2	1	1		1		3	3				22
	Komuna Qendër Fier	1	1	1	1	1	0	1	0	2	3				
ZA Lushnjë	Bashkia Lushnjë	1	1	1		1	1			3	1			1	9
DAR Elbasan	Bashkia Elbasan	1	0	2	2	5	2	1	1	4	3	1	0	0	36
	Bashkia Cërrik	1	0	2	1	4	1		1	3	3				
ZA Gramsh	Bashkia Gramsh	1	1	1				1		1	2	1			7
DAR Korçë	Bashkia Korçë	3	2	3	3	5	1	2		6	6				28
ZA Kolonjë	Bashkia Ersekë	1	1	1						1	0				7
	Bashkia Leskovik	1	1	1						1	1				
ZA Lezhë	Bashkia Lezhë	1	1	1	1	2	1	1		3	2				12
ZA Mirditë	Bashkia Rrëshen	1	1	1	1	4	1	2		2	1				21
	Bashkia Rubik	1	1	1	1	2	1	1		2	1				
DAR Kukës	Bashkia Kukës	1	1	1	2	3		1	5	1					14
ZA Has	Bashkia Krumë	1	1	1	1			1		1	1				6

ZA Kavajë	Komuna Golem	1	1	2	2		1	1	2	2	2				13
ZA Malësi e Madhe	Komuna Kelmend	1	1	1				1			1				4
DAR Shkodër	Bashkia Shkodër	4	4	4	5	9	3	6	0	11	6				48
ZA Pukë	Bashkia Pukë	1	1	1	1	2	1	2		4	1			1	14
DAR e Qyteti Tiranë	Bashkia Tiranë	6	7	7	6	15	1	5	7	20	12	7		4	91
DAR Vlorë	Bashkia Vlorë	2	2	4		4	1	2	2	6	3	2			26
Gjithsej		42	41	55	33	78	21	38	24	106	71	12	1	7	487

VENDIM
Nr.503, datë 16.4.2008

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRANIMEVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), si institucion qendror me statusin e personit juridik, publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. APRIAL-i ka si objekt të veprimtarisë shërbimet ndaj institucioneve të arsimit të lartë publik. Kjo agjenci, gjithashtu, në bazë të akteve dhe marrëveshjeve të veçanta dhe kundrejt pagesës së tarifave, që do të miratohen për këtë qëllim, mund t’u ofrojë shërbime edhe institucioneve të arsimit të lartë privat. Këto shërbime do të klasifikohen në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore në institucionet buxhetore.

3. Qëllimi i veprimtarisë së APRIAL-it është krijimi i një sistemi kombëtar, unik dhe transparent, për përcaktimin e fituesve ndërmjet maturantëve kandidatë për studime në programet e studimit, që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë.

4. APRIAL-i, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Realizon përcaktimin e fituesve ndërmjet maturantëve kandidatë për studime në institucionet e arsimit të lartë, sipas parimit meritë-preferencë, të shprehur si më poshtë vijon:

i) Parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara, në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe, për programe studimi të caktuara, edhe në bazë të plotësimit të kriterëve të veçanta, të vendosura nga institucionet e arsimit të lartë e të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

ii) Parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë, të zgjedhur prej tyre.

b) Përgatit bazën elektronike të të dhënave për maturantët kandidatë me të gjitha elementet e nevojshme të gjenealogjive, rezultateve në provimet e Maturës Shtetërore, mesataren e shkollës së mesme, e të tjera.

c) Ruan dhe administron, në formë elektronike, të gjitha të dhënat e procesit, nga fillimi dhe deri në regjistrimin përfundimtar të studentëve. Këto të dhëna ruhen në arkivin e APRIAL-it për nevoja studimore.

ç) Shqyrton ankimmimet për procesin e pranimeve në institucionet e arsimit të lartë dhe u përgjigjet të interesuarve brenda një afati të caktuar.

d) Analizon dhe përgatit të gjitha të dhënat e procesit, duke bërë edhe krahasime me vitet e mëparshme.

dh) Studion dhe propozon përmirësimin e sistemit të pranimeve në arsimin e lartë publik.

e) Realizon studime për pranimet në institucionet e arsimit të lartë, me porosi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, institucioneve të arsimit të lartë ose subjekteve të interesuara.

5. Struktura dhe organika e APRIAL-it miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6. Funksionimi i APRIAL-it bëhet në përputhje me rregulloren, e cila miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Drejtuesi i APRIAL-it emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë

7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit”.

8. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të APRIAL-it rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

9. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” caktohen në bazë të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar.

10. Numri i punonjësve të APRIAL-it, prej 6 vetash, është brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

11. APRIAL-i është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Buxheti i APRIAL-it çelët si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

12. Efektet financiare për vitin 2008, prej 12 088 000 (dymbëdhjetë milionë e tetëdhjetë e tetë mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për këtë vit, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.505, datë 1.5.2008

PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I PAKETËS SË AKSIONEVE SHTETËRORE TË MBETURA TË AMC SHA-SË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.410, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË AMC SHA-SË, QË KA MBETUR PAS TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK INVESTITORËT STRATEGJIKË, TEK ISH-PRONARËT E TRUALLIT DHE TE PUNONJËSIT E KËSAJ SHOQËRIE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communication (AMC)”” dhe të pikës 9 të nenit 5 të ligjit nr.8660, datë 18.9.2000 “Për ratifikimin e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime AMC”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, të mbetura në shoqërinë anonime AMC, të derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe të përdoren për mbulimin e:

- shpenzimeve të kryera nga kjo shoqëri për procesin e shitjes së aksioneve investitorit strategjik, në vlerën 24 880 880 (njëzet e katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë;

- shpenzimeve për shitjen e paketës shtetërore të aksioneve të mbetura, në vlerën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë;

- detyrimin tatimor pas privatizimit, në vlerën 80 922 670 (tetëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë;

- pagesës së huasë që ka kjo shoqëri ndaj “Albbakër” sha-së, në vlerën 21 000 000 (njëzet e një milionë) lekë.

2. Pika 2 e vendimit nr.410, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Shpenzimet për realizimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit për shërbimet e tij, si dhe shpenzimet e tjera, të nevojshme për transferimin e paketës, të përballohen nga të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, të mbetura në shoqërinë anonime AMC.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.506, datë 1.5.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.315, DATË 21.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EVIDENTIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE NË BASHKINË
VORË, NË KOMUNAT KASHAR E PREZË, TË QARKUT TË TIRANËS, DHE NË
KOMUNAT MAMINAS, MANZË DHE BUBQ, TË QARKUT TË DURRËSIT, TË
SHKAKTUARA NGA AKSIDENTI TEKNOLOGJIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 8 të vendimit nr.315, datë 21.3.2008 të Këshillit të Ministrave shtohen pikat 9 e 10, me këtë përmbajtje:

“9. Në rast ankesash të arsyetuara për vlerësimin apo mosvlerësimin, nga qytetarët apo subjektet, me propozimin e bashkive dhe të komunave të zonave të dëmtuara dhe me miratimin e qarqeve Tiranë dhe Durrës, ngrihen grupe të reja pune, ku të përfshihen specialistë, sipas fushave përkatëse.

10. Grupet e punës, të ngritura sipas pikës 9 të këtij vendimi, ndjekin të njëjtën procedurë vlerësimi, të parashikuar në këtë vendim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.4, datë 25.4.2008

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.12, DATË 19.7.2007 “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË AUTOVETURAVE TAKSI, SHTYPJEN DHE EMETIMIN E
BLLOKUT TË UDHËTIMIT DHE REGJISTRIT TË SHËRBIMIT TAKSI”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 35 dhe 36 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe pikës 1 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shkronjës “n” të nenit 32 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Pikat nga 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen me përmbajtje si më poshtë:

“1. Numri i licencave të lëshuara, në shkallë vendi, për shërbimin taksi me autovetura 4+1 vende do të jetë i pakufizuar;

2. Numri i licencave të lëshuara për shërbimin taksi me autoveturat taksi me 8+1 vende lejohet deri në 10% e numrit të autoveturave taksi me 4+1 vende;

3. Numri i licencave të autoveturave taksi me 8+1 vende të përcaktuara sipas udhëzimit nr.12, datë 19.7.2007, për vitin 2008 nuk ndryshon.

4. Me qëllim rritjen e standardeve të sigurisë në rrugë dhe të emetimit të gazrave, zyrat e transportit në bashki, në përputhje me rregulloren e miratuar nga këshilli bashkiak, u japin përparësi autoveturave, që kanë më pak vite nga regjistrimi i parë i tyre.”.

Pas pikës 16 shtohen pikat me përmbajtje si më poshtë:

“17. Zyrat e transportit në bashki, në përputhje me vendimin e këshillit bashkiak, dërgojnë në DPSHTRR kërkesat e tyre për shtypjen e licencave brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi. Me përjashtim të licencave rezervë, licencat e lëshuara nga zyrat e transportit në bashki, sipas udhëzimit nr.12, datë 19.7.2007, mbesin në fuqi. Shtypja e licencave do të vazhdojë me numrin e serisë të shprehur në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

18. Licencat rezervë shtypen në përputhje me aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

19. Këshilli i qarkut përcakton bashkinë korresponduese për komunat e një rrethi që ka më shumë se një bashki.

20. Bashkitë mbajnë fotokopjen e licencës para lëshimit të saj, me qëllim depozitimin në praktikën e çdo subjekti të licencuar.

21. Aneksi 1 dhe licencat rezervë të shtypura, sipas udhëzimit nr.12, datë 19.7.2007 “Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e licencave, bllokut të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi” të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, shfuqizohen.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

			ANEKSI 1		
NR.	Emërtimi i qarkut dhe kodi	Rrethi			Bashkia
		Emërtimi i bashkisë	Nr. serisë së kuotës bazë	Nr. serisë së licencave rezervë	
1	2	3	4	5	6
1	01 BERAT	Berat	BR 0155-	BR 10100-	Berat
		Kuçovë	BR 2050-	BR 10200-	Ura Vajgurore
		Skrapar	BR 3037-	BR 10300-	Kuçovë
					Çorovodë
					Poliçan
2	02 DIBËR	Dibër	DI 0086-	DI 10100-	Peshkopi
		Bulqizë	DI 2045-	DI 10200-	Bulqizë
		Mat	DI 3069-	DI 10300-	Burrel
					Klos
					Durrës
3	03 DURRËS	Durrës	DR 0315-	DR 10100-	Manëz
					Sukth
					Shijak
		Krujë	KR 2078-	DR 10200-	Krujë
					Fushë-Krujë
					Elbasan
4	04 ELBASAN	Elbasan	EL 0279-	EL 10100-	Elbasan

					Cërrik
					Belsh
		Peqin	EL 2038-	EL 10200-	Peqin
		Gramsh	EL 3041-	EL 10300-	Gramsh
		Librazhd	EL 4077-	EL 10400-	Librazhd
					Përrenjas
5	05 FIER	Fier	FR 0265-	FR 10100-	Fier
					Patos
					Roskovec
		Lushnjë	FR 2178-	FR 10200-	Lushnjë
					Divjakë
		Mallakastër	FR 3045-	FR 10300-	Ballsh
6	06 GJIROKASTËR	Gjirokastrë	GJ 0084-	GJ 10100-	Gjirokastrë
					Libohovë
		Tepelenë	GJ 2043-	GJ 10200-	Tepelenë
					Memaliaj
		Përmet	GJ 3038-	GJ 10300	Përmet
					Këlcyrë
7	07 KUKËS	Kukës	KU 0064-	KU 10100-	Kukës
		Tropojë	KU 2031-	KU 10200-	Bajram Curri
		Has	KU 3022-	KU 10300-	Krumë

8	08 KORÇË	Korçë	KO 0197-	KO 10100-	Korçë
					Maliq
		Kolonjë	KO 2028-	KO 10200-	Ersekë
					Leskovik
		Devoll	KO 3043-	KO 10300-	Bilisht
		Pogradec	KO 4091-	KO 10400-	Pogradec
9	09 LEZHË	Lezhe	LE 0099-	LE 10100-	Lezhë
		Mirdita	LE 2040-	LE 10200-	Rrëshen
					Rubik
		Kurbin	LE 3074-	LE 10300-	Laç
					Mamurras
10	10 SHKODËR	Shkodër	SH 0249-	SH 10100-	Shkodër
					Vau i Dejës
		Malësi e madhe	SH 2053-	SH 10200-	Koplik
		Pukë	SH 3035-	SH 10300-	Pukë
					Fushë-Arrëz
11	11 TIRANË	Tiranë	TR 0840-	TR 10100-	Tiranë
					Kamëz
					Vorë
		Kavajë	TR 2114-	TR 10300-	Kavajë
					Rrogozhinë

12	021 VLORË	Vlorë	VL 0235-	VL 10100-	Vlorë
					Himarë
					Orikum
					Selenicë
		Sarandë	VL 2095-	VL 10200-	Sarandë
					Konispol
		Delvinë	VL 3032-	VL 10300-	Delevinë

VENDIM
Nr.31, datë 30.4.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA
EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 57 pika 2, nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
 5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet e mëposhtme:
 - a) vendimi nr.78, datë 7.7.99 i Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e rregullores “Për kontrollin e rreziqeve të mëdha”, i ndryshuar me vendimet nr.119, datë 1.12.1999 dhe nr. 92, datë 5.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës;
 - b) vendimi nr.100, datë 10.12.2003 i Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të””.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe kriterëve për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ndërmjet tyre ose me bankën, për qëllim të administrimit të rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim:
a) të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe
b) të nenit 57 pika 2, të nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4 **Përkufizime**

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Kolateral” është secili nga mjetet e posaçme të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, të vendosura si garanci për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të kontratës së kredisë apo përmbushjen e çdo detyrimi tjetër të tij ndaj bankës.

b) “Garanci shtetërore e huasë” janë garancitë e përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 5 **Llojet e kolateralit**

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen si kolateral:

- a) depozita/t monetare pranë vetë bankës;
- b) titujt (letrat me vlerë) e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga Banka e Shqipërisë;
- c) garancitë shtetërore të huasë të Qeverisë Shqiptare, të evidentuara nëpërmjet një dokumenti zyrtar të Ministrisë së Financave ose nga çdo marrëveshje tjetër garancie, e nënshkruar në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;
- d) titujt (letrat me vlerë) e emetuar ose të garantuar në mënyrë të pakushtëzuar nga:
 - i) qeveritë qendrore dhe bankat qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe/ose të OECD;
 - ii) administrata lokale dhe rajonale e vendeve anëtare të Bashkimit Europian;
 - iii) strukturat dhe institucionet e Bashkimit Europian që gëzojnë ligjërisht të drejtën për të emetuar tituj;
- e) certifikatat e depozitave të emetuara nga vetë banka ose nga një bankë e kontrolluar nga banka në fjalë;
- f) garancitë e drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara, të lëshuara nga institucionet financiare ndërkombëtare (sipas pikës I të aneksit nr.3 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje), si edhe nga institucione të njohura dhe të specializuara në emetimin e garancive për vende të ndryshme, veçanërisht në lidhje me sigurimin e tregtisë së jashtme.

KREU II LLOGARITJA E EKSPOZIMIT TË MADH

Neni 6 **Metoda e llogaritjes së ekspozimit**

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi, grupi personash të lidhur ose një pale të tretë, llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në ekspozimin e bankës ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, të llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, zbritet vlera e kolateralit ose kolateraleve të përcaktuara sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe të vendosur/a për të siguruar detyrimet/prendimet e këtij personi ose grupi

personash të lidhur ndaj bankës.

Neni 7

Kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh

1. Ekspozimi i bankës ndaj një personi ose grupi personash të lidhur mes tyre ose me bankën, konsiderohet i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10 për qind e kapitalit rregullator të saj. Kapitali rregullator llogaritet sipas metodologjisë së përshkruar me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka respekton në çdo kohë kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh, të përcaktuara në nenin 64 si dhe kufizimet në lidhje me dhënien e kredive të përcaktuara sipas nenit 131 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

3. Këshilli drejtues i bankës përcakton rregulla të veçanta, në lidhje me dhënien e kredive personave me një marrëdhënie të veçantë me bankën, për monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të tyre, në përputhje me nenin 63 pika 3 dhe nenin 65 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

4. Këshilli drejtues miraton kreditë për personat me një marrëdhënie të veçantë me bankën. Në rast se për këto kredi përdoret si kolateral pasuri e paluajtshme, vlera e tij nuk do të jetë më e vogël se 140 për qind e vlerës së kredisë së akorduar. Në qoftë se këto kredi nuk janë plotësisht të kolateralizuara ose të garantuara, pjesa e pakolateralizuar do t'i zbritet kapitalit rregullator të bankës.

5. Administratorët e bankës, sipas politikave dhe procedurave të vetë bankës për personelin (stafin) e saj lidhur me procesin e kreditimit, nuk mund të përfitojnë kredi që tejkalojnë shumën 8.000,000 lekë ose kundërvleftën e saj në monedhë të huaj.

Neni 8

Respektimi i kufizimeve maksimale të lejueshme të ekspozimeve të mëdha

Për qëllime të llogaritjes, raportimit dhe respektimit të kufizimeve maksimale të lejueshme të ekspozimeve të mëdha, të përcaktuara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, në ekspozimin e bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur:

a) Nuk përfshihen:

i) pagesat në proces, për transaksionet e këmbimeve valutore ose të shitblerjes së letrave me vlerë, deri në ekzekutimin e tyre;

ii) zërat e aktivitetit të bilancit dhe zërat jashtë bilancit, që janë elemente zbritëse të kapitalit rregullator;

iii) të drejtat ndaj Bankës së Shqipërisë dhe ndaj Qeverisë Shqiptare kur këto shprehen në monedhën kombëtare;

iv) të drejtat ndaj Bankës së Shqipërisë, të cilat janë të garantuara plotësisht prej saj në valutë;

v) të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive qendrore të vendeve të zonës së OECD-së, shprehimisht të garantuara prej tyre dhe nga institucionet ndërkombëtare (sipas nenit 5 shkronja “f” të kësaj rregulloreje);

vi) të drejtat ndaj bankave qendrore dhe qeverive qendrore të vendeve të OECD-së, të nënshkruara, të garantuara, të financuara në monedhën e vendit huamarrës;

vii) të drejtat ndaj një debitori të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD, shprehimisht të garantuara nga bankat qendrore dhe nga qeveritë qendrore të këtyre vendeve, të nënshkruara, të garantuara, të financuara në monedhën e tyre kombëtare;

viii) të drejtat ndaj Bashkimit Europian ose institucioneve të tij, të cilat janë të garantuara shprehimisht prej Bashkimit Europian ose institucioneve të tij;

ix) të drejtat ndaj bankave shumëpalëshe (multilaterale) të zhvillimit, sipas pikës II të aneksit nr.3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje, kur këto plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- kanë vlerësime afatgjata të cilësisë së lartë nga agjencitë e klasifikimit të rrezikut (domethënë shumica e vlerësimeve të jashtme të jetë AAA);

- struktura aksionare përfshin në një masë të rëndësishme qeveri qendrore me vlerësime afatgjata AA- ose më të larta;

- ose shumica e fondeve (*fund-raising*) të saj jepen në formën e kapitalit të paguar dhe ekziston një levë financiare e vogël ose nuk ekziston një e tillë;

- mbështetja e fortë aksionare pasqyrohet në vlerën e kapitalit të paguar, të kontribuar nga aksionarët ose vlera e kapitalit të saj mund të përdoret, nëse kërkohet, për të shlyer pasivet e saj;

- evidentohen kontribute të vazhdueshme të kapitalit dhe pjesëmarrje të reja nga aksionarë - qeveri qendrore;

- nivel të mjaftueshëm kapitali dhe likuiditeti (rast pas rasti është e nevojshme një metodë për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit); dhe

- kërkesa strikte statutores kredihënieje dhe politika financiare konservative, të cilat do të përfshijnë përveç, kushteve të tjera, një proces miratimi të strukturuar, sisteme të brendshme vlerësimi të kredisë (*creditworthiness*) dhe kufij të përqendrimit të rrezikut (për vendin, sektorët e ekonomisë, ekspozimet individuale dhe kategoritë e kredisë), miratim të ekspozimeve të mëdha nga këshilli ose një komitet i tij, grafik të fiksuar shlyerjeje, monitorim efektiv të përdorimit të procedurave, proces të rishikimit të statusit dhe vlerësim rigoroz të rrezikut dhe fondeve të provigjonimit për humbjet nga kredia;

x) angazhime për lehtësi në llogari të zbuluar të papërdorura, që kanë të bëjnë me huadhënien, me blerjen e letrave me vlerë, të pranimeve bankare me afat fillestar maturimi jo më shumë se një vit. Lehtësitë në llogari të zbuluar mund të anulohen në çdo kohë, pa kushte dhe pa paralajmërim;

xi) zëra të tjerë jashtë bilancit me rrezik të vogël, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë;

b) Përfshihen në shuma të reduktuara me 20 për qind të ekspozimit:

i) të drejtat me afat deri në maturim jo më shumë se 1(një) vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë;

ii) të drejtat ndaj bankave shumëpalëshe (multilaterale) të zhvillimit (sipas aneksit nr.3 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje);

iii) të drejtat ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në vendet e OECD-së dhe shprehimisht të garantuara prej tyre, me përjashtim të rastit kur këto të drejta, sipas rregullave në fuqi, përfshihen në kapitalin rregullator të tyre;

iv) të drejtat ndaj organeve të qeverisjes qendrore, rajonale dhe lokale, të vendeve të zonës OECD;

v) të drejtat me afat deri në maturim jo më shumë se 1 (një) vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD ose të drejtat mbi 1 (një) vit, ose të garantuara shprehimisht nga bankat qendrore dhe nga qeveritë qendrore të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD, me përjashtim të rastit kur këto të drejta sipas rregullave në fuqi përfshihen në kapitalin rregullator të tyre;

vi) angazhime për kredinë dokumentare, të dhënë ose të konfirmuar, me garancinë e mallrave korrespondues dhe operacione të tjera të ngjashme;

vii) zëra të tjerë jashtë bilancit me rrezik të moderuar, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë.

c) përfshihen në shuma të reduktuara me 50 për qind të ekspozimit:

i) të drejtat që lindin nga kredia hipotekore dhe që kanë si objekt blerjen e një prone rezidenciale (shtëpi, apartament), blerësi i të cilës është kredimarrësi. si dhe janë të kolateralizuara në mënyrë të plotë me anë të një hipoteke mbi një pronë rezidenciale, e cila është në pronësi të kredimarrësit dhe është në përdorim ose jepet me qira prej tij;

ii) operacionet e qirasë financiare të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara;

iii) angazhime për të paguar kredinë dokumentare, të dhënë ose të konfirmuar, pa garancinë e mallrave korrespondues;

iv) garancitë për finalizim të mirë të operacionit dhe angazhimet doganore dhe fiskale, me kusht që të mos përbëjë zëvendësim të dhënësit fillestar të kredisë;

v) angazhimet për të marrë aktivet e dhëna për sa kohë mbajtësi i tyre ka një mundësi rishitjeje;

vi) angazhime për çelje letërkredie;

vii) angazhime për lehtësi në llogari të zbuluara të papërdorura, që kanë të bëjnë me huadhënien, me blerjen e letrave me vlerë, të pranimeve bankare me afat fillestar maturimi më shumë se 1 (një) vit. Lehtësitë në llogari të zbuluara janë të konfirmuara dhe të pakthyeshme;

viii) angazhime për lehtësi në emetimin e letrave me vlerë;

ix) zëra të tjerë jashtë bilancit me rrezik të mesëm, të klasifikuar nga vetë banka dhe të

vlerësuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë;

d) Përfshihen në shuma të reduktuara marrëdhëniet (të drejtat) që përfaqësojnë kontrata financiare me afat, lidhur me normat e interesit dhe kurset e këmbimit, respektivisht sipas tabelës së mëposhtme:

Kontrata financiare me afat maturimi	Lidhur me normat e interesit	Lidhur me kurset e këmbimit
< 1 vit	0.5 për qind	2 për qind
1 deri 2 vjet	1 për qind	5 për qind
për çdo vit shtesë për afat > 2 vjet	1 për qind	3 për qind

KREU III MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 9

Kërkesat monitoruese dhe mbikëqyrëse

1. Bankat miratojnë dhe zbatojnë procedura dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm, që garantojnë identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të ekspozimeve të mëdha dhe të ndryshimit të vlerës së tyre.

2. Bankat detyrohen të raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë për çdo rast të ekspozimit të madh dhe/ose të tejkalimit të kufizimeve maksimale të lejueshme të ekspozimeve të mëdha, sipas përcaktimeve të neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë përcakton dhe njofton bankën për kohën dhe masat e nevojshme, me qëllim rivendosjen e ekspozimeve brenda kufizimeve maksimale të lejueshme.

3. Kuadri i përgjithshëm i procedurave administrative dhe kontabël, si dhe i sistemeve të informacionit në lidhje me identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e marrëdhënieve dhe ekspozimeve të bankës ndaj personave të lidhur, është subjekt i inspektimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm nga Banka e Shqipërisë.

Neni 10

Kërkesa raportuese

1. Banka plotëson dhe dorëzon në fund të çdo 3 (tre)-mujori në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularët nr.1 dhe nr.2 për respektimin e kufizimeve maksimale të lejuara të ekspozimeve të mëdha, sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje; dhe

b) Formularin nr.3, për marrëdhëniet me personat e lidhur me të, sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Grupi bankar raporton mbi baza të konsoliduara për ekspozimet maksimale të lejueshme dhe marrëdhëniet me personat e lidhur, çdo 6 (gjashtë)-mujor. Ky raportim kryhet sipas formularëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Banka e Shqipërisë, në çdo rast që e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë dhe të urdhërojë ndryshime në përmbajtjen dhe në shpeshtësinë e raportimit.

Neni 11

Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, kur konstaton mosrespektimin nga bankat të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat administrative, mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore të parashikuara në nenet 74 deri në 81 dhe në nenin 89 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

ANEKSI NR.1

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.1

MATJA DHE KONTROLI I EKSPOZIMEVE MAKSIMALE (në mijë lekë) Emri i bankës.... Periudha raportuese Data e raportimit Përgatiti (emër, mbiemër, firmë) Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)
--

KAPITALI RREGULLATOR	SHUMAT
KAPITALI RREGULLATOR NË FILLIM TË PERIUDHËS :	
SHTESAT (+) / PAKËSIMET (-) GJATË PERIUDHËS :	
KAPITALI RREGULLATOR NË FUND TË PERIUDHËS :	
(20%) E KAPITALIT RREGULLATOR:	
(10%) E KAPITALIT RREGULLATOR:	
(700%) E KAPITALIT RREGULLATOR:	////////////////////

EKSPOZIMET E MËDHA			
Klienti/ personi dhe grup klientët e lidhur	Ekspozimet (1)	Garancitë/ kolateralet e zbritshme (G) (2)	Ekspozimet pas zbritjes së (G) (3)=(1) - (2)
Totali i ekspozim eve të mëdha			

FORMULARI I RAPORTIMIT NR.2

MATJA DHE KONTROLI I EKSPOZIMEVE MAKSIMALE (në mijë lekë) Emri i bankës Periudha raportuese Data e raportimit Përgatiti (emër, mbiemër, firmë) Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

KAPITALI RREGULLATOR	SHUMAT
KAPITALI RREGULLATOR NË FILLIM TË PERIUDHËS :	
SHTESAT (+) / PAKËSIMET (-) GJATË PERIUDHËS :	
KAPITALI RREGULLATOR NË FUND TË PERIUDHËS :	
(25%) E KAPITALIT RREGULLATOR :	
(10%) E KAPITALIT RREGULLATOR :	
	////////////////////

EKSPOZIMET PËR KLIENTËT/PERSONAT E LIDHUR ME BANKËN			
Klientë/ Persona të lidhur me bankën	Ekspozimet (1)	Garancitë/ kolateralet e zbritshme (G) (2)	Ekspozimet pas zbritjes së (G) (3)=(1) - (2)
a) sipas formularit 3			
b) sipas formularit 3			
.....			
n. sipas formularit 3			
Totali i veprimeve			
Totali i ekspozime ve të mëdha			

ANEKSI NR.2

FORMULARI NR.3
MARRËDHËNIET E BANKËS ME KLIENTËT/PERSONAT E LIDHUR ME BANKËN

Emri i bankës Periudha raportuese Data e raportimit Përgatiti (Emër, mbiemër, firmë) Drejtuesi (Emër, mbiemër, firmë)
--

Përbërja	Të drejtat (1)	Detyrimet (2)	Veprimet jashtë – bilancit (të dhëna) (3)	Veprimet jashtë – bilancit (të marra) (4)
a) Individ:				

b) Person fizik:				

c) Person juridik :				

1. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	////////	////////		
a) Individ:				

b) Person fizik:				

c) Person juridik:				

2. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	////////	////////		

a) Individ:				

b) Person fizik:				

c) Person juridik:				

n) Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	////////	////////		
Totali i veprimeve me personat e lidhur (1+2+..+n)	////////	////////		

ANEKSI NR.3

I. Lista e institucioneve financiare ndërkombëtare:

- a) Komuniteti European (KE)
- b) Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- c) Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS).

II. Lista e bankave shumëpalëshe të zhvillimit:

- a) Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD - Grupi i Bankës Botërore)
- b) Shoqëria Financiare Ndërkombëtare (IFC – Grupi i Bankës Botërore)
- c) Banka Ndëramerikane e Zhvillimit (IADA)
- d) Banka Aziatike e Zhvillimit (ADB)
- e) Banka Afrikane e Zhvillimit (ADB)
- f) Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEDB)
- g) Banka Nordike e Investimit (NIB)
- h) Banka për Zhvillim e Karaibeve (CDB)
- i) Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)
- j) Banka Europiane e Investimeve (EIB)

- k) Fondi European i Investimeve (EIF)¹
- l) Agjencia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve (MIGA – grupi i Bankës Botërore)
- m) Lehtësia Financiare Ndërkombëtare për Imunizim (IFFI)
- n) Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)
- o) Shoqëria Ndëramerikane e Investimeve (IAIC)
- p) Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB)
- q) Banka e Amerikës Qendrore për Integrim Ekonomik (CABEI) ose
- r) Të tjera banka shumëpalëshe të zhvillimit.

VENDIM
Nr.24, datë 2.5.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË LËNDËVE DJEGËSE, TË KONSUMUAR NË SERAT ME NGROHJE PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE INDUSTRIALE DHE AGROINDUSTRIALE, TË CILAT PËRDOREN PËR NEVOJAT TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|-----------|
| - z. Genc Ruli | - Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | - Anëtare |
| - znj. Mimoza Vokshi | - Anëtare |
| - znj. Ardiana Shehi | - Anëtare |

Në mbledhjen e tij të datës 2.5.2008 shqyrtoi raportin “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Financave me shkresën nr.2980, datë 31.3.2008 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/N/006/2008, datë 11.4.2008.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e këtij përjashtimi është neni 1 i ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar”, i cili ndryshon nenin 19 pika 2 shkronja “d” të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, si dhe projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”.

OBJEKTIVI/AT: Skema synon të krijojë kushte lehtësuese për ndërmarrjet që do të përdorin lëndët djegëse për nevojat teknologjike të prodhimit, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, si dhe për subjektet që kanë serat me ngrohje dhe që përdorin lëndët djegëse mazut e solar.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema i përmbush të gjitha kushtet për t’u vlerësuar si ndihmë shtetërore.
2. Sektorët e serave me ngrohje dhe industrisë agropërpunuese nuk hyjnë në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.
3. Me miratimin e ligjit nr.9598, datë 27.7.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar”, është bërë një ndryshim thelbësor në akcizën e lëndëve

¹ Të drejtat ndaj Fondit Evropian të Investimeve për pjesën e papaguar të kapitalit të nënshkruar të tij (Fondit) do të përfshihen gjithnjë me shuma të reduktura me 20 për qind të ekspozimit.

djegëse (mazut dhe solar), duke e rritur atë nga 1 lek/l në 13 lekë/1, gjë që ka sjellë rritje të ndjeshme të koston së prodhimit të produkteve, në procesin teknologjik të të cilave përdoren lëndët djegëse mazut e solar.

4. Gjatë viteve të fundit ka pasur kriza të vazhdueshme të mungesës së furnizimit me energji, të kushtëzuara edhe nga kushtet e pafavorshme të motit, gjë e cila ka sjellë domosdoshmërinë për gjetjen e burimeve alternative (përfshirë përdorimin e lëndëve djegëse, mazut e solar) për plotësimin e nevojave teknologjike të prodhimit.

5. Skema e sugjeruar parashikon një ndihmë operationale, e cila, në parim, është e ndaluar. Ajo nuk ka karakter incentivues për ndërmarrjet përfituese dhe nuk i kushtëzon ato për investime efikente dhe efektive në përmbushjen e kushteve të mjedisit.

6. Skema ka karakter selektiv, të cilin e përforcon edhe përzgjedhja e vetëm disa prej sektorëve të prodhimeve industriale për mundësi përfitimi prej saj, gjë që shprehet në relacionet shoqëruese të akteve normative dhe në anekset përkatëse.

7. Nga ana e Ministrisë së Financave nuk janë paraqitur të dhëna për afatet kohore të zbatimit të skemës, impaktin në buxhet për të gjithë periudhën kohore të zbatimit të masës, si dhe ndryshimet e akcizës për lëndët djegëse që përdoren për prodhimin e produkteve industriale në vite.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13 shkronja “b”, nenin 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Në mënyrë që skema, për sa i takon përjashtimit nga akciza e lëndëve djegëse mazut e solar për prodhimin e produkteve industriale, të jetë e lejueshme, duhet që:

i) përjashtimi të jetë i kufizuar në kohë, jo më shumë se 5 vjet;

ii) përjashtimi të mos jepet vetëm për produkte të veçanta industriale apo vetëm për sektorë të veçantë të industrisë; sektori i prodhimit të çelikut nuk mund të marrë ndihmë në kuadër të kësaj skeme dhe të asnjë skeme tjetër, pasi i nënshtrohet rregullave të veçanta të parashikuara në protokollin e çelikut;

iii) masa të jetë proporcionale dhe të shkojë duke u reduktuar nga viti në vit. Për këtë, nëse skema do të vazhdojë pesë vjet, rimbursimi total i akcizës të kryhet vetëm për tri vitet e para të zbatimit të skemës, në vitin e katërt të bëhet një rimbursim në masën 80% të akcizës dhe në vitin e pestë një rimbursim në masën 50% të saj.

2. Ndihma e përfituar nëpërmjet përjashtimit nga akciza e lëndëve djegëse, nuk mund të përshtohet me asnjë formë tjetër ndihme nga çfarëdo burimi shtetëror. Në rast se ndërmarrjet përfituese në kuadër të kësaj skeme kanë përfituar apo mendohet të përfitojnë nëpërmjet formave të tjera të ndihmës shtetërore, përfshi edhe format koncesionare apo nismën “Shqipëria 1 euro”, Ministria e Financave duhet të kryejë njoftimin për ndihmën individuale dhe të kërkojë miratimin e KNSH-së.

3. Ministria e Financave të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH-së, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme apo për çdo ndihmë individuale sipas pikës 2 të këtij vendimi, gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Nëse nuk përmbushen kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi ose ndërmarrjet përfituese e keqpërdorin ndihmën, ato janë të detyruara të kthejnë të gjithë ndihmën e marrë, së bashku me interesat, që nga data e përfitimit të saj.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM

Nr.25, datë 2.5.2008

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE PËR PËRJASHTIMIN NGA AKCIZA TË LËNDËVE DJEGËSE, TË PËRDORUARA PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TERMOCENTRALET ME FUQI MË TË MADHE SE 5MW

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|-----------|
| - z. Genc Ruli | - Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | - Anëtare |
| - znj. Mimoza Vokshi | - Anëtare |
| - znj. Ardiana Shehi | - Anëtare |

Në mbledhjen e tij të datës 2.5.2008 shqyrtoi planin e dhënien së ndihmës shtetërore “Për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW”, paraqitur pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Drejtoria e Politikave Elektroenergjetike në METE me shkresën nr.9785/3, datë 29.1.2008 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AL/N/007/2008, datë 24.4.2008.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e këtij përjashtimi është ligji nr.8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, ligji nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.839, datë 5.12.2007 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursim të akcizës së paguar dhe përjashtimin nga taksa doganore për makineritë dhe pajisjet, përdorur nga burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW”.

OBJEKTIVI/AT: Skema synon të krijojë kushte lehtësuese për ndërmarrjet që ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi me të madhe se 5MW, nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse, për të siguruar plotësimin e nevojave me energji në vend.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema synon të ndihmojë ndërmarrjet që do të ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW, në formën e rimbursimit të akcizës për lëndët djegëse të përdorura nga këto ndërmarrje për nevojat e veta apo për shitje.

2. Prodhimi i brendshëm i energjisë elektrike bazohet kryesisht (në masën 97%) në burimet hidrike. Si rezultat i kushteve të vështira të motit dhe pamundësisë për të plotësuar nevojat me energji, vitet e fundit vendi ka kaluar kriza të thella energjetike. Nëpërmjet kësaj skeme synohet të krijohen kushte lehtësuese për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese, duke parashikuar plotësimin e nevojave të vendit me energji, rritjen e diversitetit të burimeve të energjisë dhe zvogëlimin e vartësisë së furnizimit me energji elektrike nga kushtet e motit në vendin tonë.

3. Skema vlerësohet si një masë për të mënjeluar gjendje të rënda në ekonominë e vendit dhe që mund të zbatohet për sa kohë që nuk prek rregullat e tregtisë ndërkombëtare.

4. Skema e sugjeruar parashikohet të jepet deri në vitin 2015, që përkon me vitin e liberalizimit të plotë të tregut të energjisë, për caktuar në Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë.

5. Gjatë shqyrtimit të bazës ligjore, vërehet se ligji nr.9765, datë 9.7.2007, që amendon ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, ligji nr.8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.839, datë 5.12.2007, nuk e kufizojnë në mënyrë të shprehur përjashtimin vetëm të termocentralet me fuqi të instaluar mbi 5 MW.

6. Si strukturë për ndjekjen e zbatimit të skemës është ngarkuar Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

7. AKBN ka paraqitur të dhënat për 4 ndërmarrje, që aktualisht kanë mundësinë të ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW dhe, si të tilla, mund të përfitojnë nga zbatimi i skemës. Sipas modelit dhe të dhënave të paraqitura nga AKBN, intensiteti i ndihmës shtetërore është llogaritur 23,75%.

8. Dhënësi i ndihmës argumenton se skema nuk përdoret për burime me fuqi të instaluar më të vogël se 5 MW për arsye se ato konsiderohen joeficiente në shfrytëzimin e lëndës djegëse.

9. Skema nuk duket se ka karakter incentivues për ndërmarrjet përfituese, në drejtim të investimeve të reja me teknologji moderne dhe eficiente në përbushjen e kushteve mjedisore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13 shkronja b dhe nenin 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Skema e përjashtimit nga akciza për lëndët djegëse, të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW për burim, për nevojat e veta ose për shitje brenda vendit, duke respektuar edhe aktet e tjera normative në fuqi, të lejohet, me kusht që akciza e lëndëve djegëse të përdorura të rimbursohet deri në masën 80%. Pjesa tjetër prej 20% të përballohet nga ndërmarrjet përfituese.

2. Investimet që do të përdoren për gjenerimin e energjisë duhet të jenë investime të reja, me teknologji moderne që respekton të gjitha standardet mjedisore. Ndërmarrjet janë të detyruara të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku të marrin përsipër përmirësimin e efijencës së tyre për sa i takon respektimit të kushteve mjedisore.

3. Ndihma e përfituar nga kjo skemë, nëpërmjet përjashtimit nga akciza e lëndëve djegëse, nuk mund të përshtohet me asnjë formë tjetër ndihme nga çfarëdo burimi shtetëror. Në rast se ndërmarrjet përfituese në kuadër të kësaj skeme kanë përfituar apo mendohet të përfitojnë nëpërmjet formave të tjera të ndihmës shtetërore, përfshi edhe format koncesionare apo nismën “Shqipëria 1 euro”, Drejtoria e Politikave Elektroenergjetike në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës duhet të kryejë njoftimin për ndihmën individuale dhe të kërkojë miratimin e KNSH-së.

4. AKBN, brenda datës 31 mars të çdo viti, të raportojë pranë DNSH-së për të dhënat e zbatimit e skemës së ndihmës dhe çdo ndihmë individuale që mund të përfitohet sipas pikës 3 të këtij vendimi në vitin paraardhës financiar.

5. Nëse nuk përbushen kushtet e parashikuara në pikat 1-3 të këtij vendimi ose ndërmarrjet përfituese e keqpërdorin ndihmën, ato janë të detyruara të kthejnë të gjithë ndihmën e marrë, së bashku me interesat, që nga data e përfitimit të saj.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM Nr.50, datë 18.4.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2008 PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12, pika 1 dhe 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2008, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së

Tarifave dhe Çmimeve mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2008 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit sipas nivelit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2007 nga secili operator i licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2008 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Nr.	Kompania	Pagesa e rregullimit për vitin 2008 (në lekë)
1	ALBANAN GREEN ENERGY sh.p.k.	300 000
2	BALKAN GREEN ENERGY sh.p.k.	185 000
3	EMIKEL sh.p.k.	31 000
4	AMAL sh.p.k.	10 000
5	SPAHIU-GJANÇ sh.p.k.	60 000
6	WONDER-POWER sh.a.	45 000
7	PROJEKSION ENERGJI sh.a.	5 000
8	SAROLLI sh.p.k.	1 000
9	JUANA sh.p.k.	2 000
10	WTS energji sh.p.k.	6 000
11	MARJAKAJ sh.p.k.	5 000
12	MAKSI ELEKTRIK sh.p.k.	8 000
13	DARDANIA ENERGJI sh.p.k.	1 000
14	FAVINA 1 sh.p.k.	46 000
15	ENERGO SAS sh.p.k.	1000
16	GSA sh.p.k.	60 000
17	DARFO	50 000
18	OST sh.a.	4 725000
19	KESH sh.a.	49 709000
	Shuma për ERE-n	55 250000

VENDIM

Nr.51, datë 9.5.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “E-VENTO S.R.L. ALBANIA” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a” dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 dhe nenit 18 pika

3 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.5.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimi i energjisë elektrike, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit,

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për licencimin e shoqërisë “E-Vent s.r.l. Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.52, datë 9.5.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.46, DATË 10.8.2007 “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË GJOBAVE DHE LLOGARITJES SË DËMIT, QË DO TË APLIKOHEN NDAJ KLIENTËVE ME KUNDËRVAJTJE NË PËRDORIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 46/1, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.38, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave për një shtesë në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit, që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike””, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.5.2008, pasi diskutoi mbi mënyrën e llogaritjes së dëmit të shkaktuar nga konsumatorët në kundërvajtje të përdorimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit që do të aplikohet ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike” pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen:

3. Për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë në kundërvajtje të përdorimit të energjisë elektrike, në rastet kur çmimi i shitjes së energjisë elektrike është i ndryshëm në varësi të sasisë së konsumit apo të kohës së konsumit, sasia e kwh-së së faturuar si dëm të llogaritet bazuar në çmimin maksimal të shitjes së energjisë elektrike në përputhje me kategorinë e konsumatorit.

2. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojnë KESH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESE
Nr.2666/1, datë 30.4.2008

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrëshen – Kalimash”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga grupi i punës ngritur për këtë qëllim, vlerësim i cili është miratuar më pas nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ju bëjmë në dije që vlerësimi i objekteve është bërë në bazë të zërave të punimeve të evidentuara dhe të dokumentuara në prezencë të pronarëve, të cilët kanë firmosur më pas procesverbalet respektive. Ndërsa çmimet për çdo zë punimi janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave, kjo në mbështetje të akteve ligjore të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private, për interes publik.

Të gjithë pronarët, për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi këtë përfunduar procesi i regjistrimit dhe pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (Subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private, për interes publik”).

Pronarët, për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 47 415 531 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë.

**LISTA E PRONAREVE PASURITE (OBJEKTE) NE PRONESI TE TE CILEVE PREKEN
NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRESHEN - KALIMASH**

NR.	PRONARI		NR. PASURISE	VLERA LEKE	FSHATI	SHENIME
	EMRI	MBIEMRI				
1	PRENG	GJON	MARPEPA	173	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
2	NDUE	NIKOLL	NDOJ	200	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
3	ARDIAN	FRAN	PRENGA	143	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
4	NDUE	FRROK	MARKU	170	MASHTERKOR	KONFIRMUAR NGA ZRPP
5	AGUSTIN	ZEF	MARKU	43/1	SHTRUNGAI	KONFIRMUAR NGA ZRPP
6	PASHK	DED	NIKOLLI	59/7	SHTRUNGAI	KONFIRMUAR NGA ZRPP
7	GEZIM	MARK	GJOKA	81/11	SHTRUNGAI	KONFIRMUAR NGA ZRPP
8	RROK	GJET	GJERGJI		ZALL-XHUXH	PROCES REGJISTRIMI
9	MARTIN	NDUE	GJETA	30	ZALL-XHUXH	KONFIRMUAR NGA ZRPP
10	ZEF	LLESH	MENA	206	ZALL-XHUXH	KONFIRMUAR NGA ZRPP
11	ZEF	NDUE	KARACI	193	ZALL-XHUXH	KONFIRMUAR NGA ZRPP
12	SHKELZEN	DED	PRENDI	88/2	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
13	MEHILL	KOL	GJOKA	112/4	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
14	NDUE	MEHILL	GJOKA	112/5	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
15	PAULIN	DED	PRENDI	88/5	BLINISHT	KONFIRMUAR NGA ZRPP
16	NIKOLL	NDUE	GJERGJI		SANG	PROCES REGJISTRIMI

17	DED	NDUE	NDOJ	161	1837939	SANG	KONFIRMUAR NGA ZRPP
18	NDUE	PRENG	PRENGA		1216783	SANG	PROCES REGJISTRIMI
19	GJOK	NDUE	NDOJ	162	2091319	SANG	KONFIRMUAR NGA ZRPP
20	GJERGJ	ZEF	NDRECA	69/3	1546731	KLOS	KONFIRMUAR NGA ZRPP
21	CUP	NIKOLL	BOCI		1426955	KLOS	PROCES REGJISTRIMI
22	KOL	NDUE	LLESHI	88/6	3493059	KLOS	KONFIRMUAR NGA ZRPP
23	DAVA	NIKOLL	TUCI	84/5	2021959	KLOS	KONFIRMUAR NGA ZRPP
24	PASHK	FRROK	NIKOLLI	144/1	1313121	GEZIQ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
25	GJET	NIKOLL	PERSHQEFA	60	2395460	BISAK	KONFIRMUAR NGA ZRPP
		TOTALI			47415531		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.5.2008
Doli nga shtypi më 21.5.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë